



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

---

**VENDIM**

*Nr. 149 Datë 29.10.2012*

**PER**

**NJE NDRYSHIM TE PIKES 2 TE VENDIMIT NR. 143, DATE 24.10.2012,  
TE BORDIT TE KOMISIONEREVE TE ERE-SE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “dh” dhe 9 te Ligjit 9072, date 22.95.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, te ndryshuar, Nenit 11 te Kodit te Procedurave Administrative, pikes 7 germa “b”, te Modelit te Tregut te Energjise Elektrike te miratuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 338, date 19.03.2008, te ndryshuar, Kapitullit X te rregullave te Tregut Shqiptar te Energjise Elektrike, te miratuar nga ERE me Vendimin e Bordit te Komisionereve nr. 68, date 23.06.2008, si dhe pikes 2 te Nenit 16 te Rregullave te Praktikës dhe Prcedurave te ERE, miratuar me Vendimin nr. 21, date 18.03.2009 te Bordit te Komisionereve, te ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 29.10.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut,

**Duke konsideruar se:**

Vendimi 143, date 22.08.2012, i Bordit te Komisionereve te ERE-se, reflektonte parimin e barazise ne alokimin e kapaciteteve dhe pageses perkatese ndermjet pjestareve te tregut.

Perfitues nga Pika 2 e Vendimi 143 te Bordit te Komisionereve te ERE-se, eshte vetem nje Furnizues i Kualifikuar.

Furnizuesit e tjere te kualifikuar i kane fituar kapacitetet e nevojshme per furnizimin e Klienteve te Kualifikuar me pagese ne ankandin vjetor te zhvilluar nga ana e OST sh.a.

Për sa më sipër, Bordi i Komisionerëve,

**Vendosi:**

1. Subjektet e përcaktuara sipas detyrimit në pikën 2 të Vendimit nr. 143, datë 24.10.2012, për kapacitetet e siguruara të interkonjeksionit për muajin Nentor 2012, do të paguajnë OST-se vlerën sipas rezultateve të ankandit vjetor.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë për këtë vendim të Bordit të Komisionerëve, shoqërinë OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**